

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin mars

2024

prill 2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin mars

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, prill 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit mars 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i njëzetë e një mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në bazë të monitorimit dhe trajtimit të 62 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit mars 2024, rezulton që artikujt clickbait dhe lajmi i rremë kanë dominuar për sa i përket kategorive keqinformuese. Në kuadër të këtij muaji, clickbait dhe lajm i rremë kryesojnë me 21% dhe dezinformata me 20%.

Ashtu si në muajin paraprak (shkurt 2024) ku kishin dominuar përmbajtjet clickbait, edhe gjatë marsit kjo kategori keqinformuese ka mbizotëruar, për shkak se një shumësi e keqinformatave të publikuara nga fusha e politikës, kronikës së zezë dhe socialja janë vlerësuar si clickbait. Për shkak që gjatë këtij muaji, keqinformata nuk janë fokusuar në një temë që ka marrë përqendrimin kryesor dhe se disa përmbajtje keqinformuese nga fusha kryesore janë vlerësuar si clickbait, ka bërë që kjo kategori të radhitet me përqindjen më të lartë.

Kjo kategori pasohet nga lajmi i rremë, i cili ka përqindjen e njëjtë me kategorinë clickbait, pra 21%. Lajmet e rreme u publikuan në rrjete sociale për tema të ndryshme politike, sociale, kronikë e zezë dhe të tjera. Krahasuar me muajin shkurt kategoria e lajmit të rremë ka shënuar rritje prej 14% (7% në shkurt, 21% në shkurt).

Lajmi i rremë pasohet nga dezinformata, si një nga format më të shpeshta të keqinformatave të publikuara e cila radhitet në vendin e tretë. Kjo kategori ka shënuar rritje prej 8% krahasuar me muajin shkurt (13% në shkurt, 20% në mars).



21% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “clickbait” dhe “lajm i rremë”

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Clickbait

Të gjitha përmbajtjet e vlerësuara si “clickbait” janë publikuar nga publikues (media reale, dhe media sociale) në gjuhën shqipe. Kronika e zezë (5%), socialja (5%) dhe politika (5%) ishin dy fushat kryesore lidhur me të cilat u publikuan artikujt clickbait, duke mos munguar edhe fushat tjera si, siguria, sporti dhe moti.

03. Dezinformatë

Dezinformatat u publikuan kryesisht në media reale (10%) dhe media sociale (8%) nga politika, socialja dhe siguria. Në mediat në gjuhën serbe u publikuan deklarata të paqëndrueshme nga Zaharova për intervenimin e NATO-s më 1999 dhe “trazirat e marsit 2004”, si dhe pretendime të pabazuara për të ashtuquajturën “Shtëpi e verdhë”. Ndërsa në gjuhën shqipe u publikuan për vendimin e BQK-së për dinarin, luftën në Ukrainë, veriun, Asociacionin e Komunave Serbe etj.

05. Përmbajtje e paverifikuar

Këto përmbajtje u publikuan në media reale (8%) dhe media sociale (3%), për tema të ndryshme ku mbizotërojnë imazhet e publikuara me pretendimin se paraqesin minatarorët e Trepçës duke ngrënë syfyr në 800 metra edhe pse bëhej fjalë për imazh të realizuar në Turqi, si dhe fotografia e dekorimit të qyteteve për muajin e Ramazan. Krahas këtyre u publikuan edhe përmbajtje të paverifikuara ndërlidhur me armatosjen e FSK-së, gjykatën speciale e konfliktin Izrael-Hamas.

02. Lajm i rremë

Pothuajse të gjitha lajmet e rreme janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale. Siguria, kronika e zezë dhe politika janë fushat në të cilat kanë zënë vend më shumë lajmet e rreme. U publikuan lajme të rreme për vdekjen e djalit të artistit, Ardit Gjebrea, pretendime të rreme për zhvillime në kufirin Kosovë-Serbi, për veriun, armatosjen e FSK-së.

04. Mashtrim

Pothuajse të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga fusha sociale dhe një nga siguria. Përmbajtja nga fusha e sigurisë kishte të bënte me hapjen e një ueb-faqeje të publikuar për mbledhjen e fondeve për FSK-në. Ndërsa keqinformatat mashtruese nga fusha sociale ishin për shitjen online të produkteve të dyshimta me pretendimin se shërojnë sëmundje të caktuara, si dhe publikime të kampanjave të rreme për dhënie kredish nga faqe të dyshimta në Facebook.

06. Clickbait /Dezinformatë


Përmbajtjet clickbait/dezinformatë u publikuan lidhur me temën e kushteve klimatike, përfshi këtu artikuj të vjetër për përkeqësim të motit dhe paralajmërime për përmbyse nga shiu në Shqipëri, u publikohuan si aktuale. Të gjitha këto u publikuan në media sociale.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: gabim, teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Disa pretendime të rreme të publikuara nga publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe media sociale) për zhvillime në fushën e sigurisë në veriun e Kosovës, ka bërë që kjo temë të dominojë gjatë muajit mars. Shumëllojshmëria e temave ka bërë që, edhe pse kjo temë mbizotëron, përqindja e keqinformatave lidhur me të është e ulët. Krahasuar me muajin paraprak (shkurt) tema e veriut me 5% radhitej si e gjashta në mesin e temave për të cilat u keqinformua më së shumti. Ndërsa, në këtë muaj, me 8% radhitet si e para, për shkak të shumëllojshmërisë së temave për të cilat u keqinformua gjatë këtij muaji.

Gjatë muajit mars u publikuan disa përmbajtje mashtruese lidhur me pretendime për produkte që shërojnë sëmundje të ndryshme. Kjo ka bërë që gjatë këtij muaji të gjenden dhe trajtohen mashtrime të tilla lidhur me këtë temë, që ka ndikuar që kjo temë të radhitet si e dyta.

Në kuadër të përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara gjatë këtij muaji, janë publikuar lajme të vjetra lidhur me kushtet klimatike më pretendimin t'i paraqesin si aktuale. Po ashtu, janë publikuar edhe përmbajtje mashtruese me pretendimin për dhënie kredish apo shprehje të kënaqësisë së konsumatorëve për kreditë. Përmbajtjet e koduara si raste tragjike (vdekje e vrasje), ku përveç artikujve clickbait për të cilat nuk bëhet e ditur në titull vendndodhja e ngjarjes, janë publikuar edhe lajme të rreme me pretendime për vdekjen e djalit të artistit Ardit Gjebrea, etj.



32% e temave kryesore janë për veriun, produkte shëruese, kushtet klimatike, dhënie kredish, raste tragjike dhe muaji i Ramazanit

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Veriu

Keqinformatat ndërlidhur me veriun u publikuan në media sociale (5%) dhe media reale (3%). Pjesa dërrmuese e përmbajtjeve lidhur me këtë temë janë nga fusha e sigurisë (5%) pasuar nga socialja (2%) dhe politika (2%). Në media u publikuan pretendim i rremë për deklaram të publicistit Shkelzen Maliqi, se 007 janë futur në veri të Kosovës, si dhe artikulli clickbait ku titulli nuk e bën të qartë se gjobat për regjistrim të popullsisë do të përfshijnë gjithë vendin, dhe jo vetëm veriun. Ndërsa në mediat sociale u publikuan lajmi i rremë se Kosova po ndërton katër baza ushtarake në kufi me Serbinë, përmbajtje e paverifikuar se është vendosur flamuri i Rusisë në kalanë e Zveçanit dhe teori konspirative në gjuhën serbe se aksioni kundër barnave të kontrabanduara në veri përbënë “veprim antiserb”.

03. Kushtet klimatike

Keqinformatat për kushtet klimatike u vlerësuan si clickbait dhe clickbait/dezinformatë të cilat u publikuan në media sociale dhe media reale. Lidhur me këtë temë u publikuan artikuj të vjetër për përkeqësim të motit dhe përmbysje nga shiu në Shqipëri, me pretendimin të paraqiten si aktuale.

02. Produkte shëruese

Përmbajtjet keqinformuese lidhur me temën në fjalë janë publikuar në media sociale (5%) dhe portale të dyshimta (2%). Të gjitha këto përmbajtje u vlerësuan si mashtrim dhe ndërlidheshin me temat si: Produkti bimor paraqitet rrejshëm si mjaltë për shërimin e lukthit, produkti shitet online si 100% natyral me emërtimin “mjaltë për potencë”, shitet online produkti “O CAPS” me pretendimin e rremë se është ilaç që ndihmon në rikthimin e shikimit.

04. Dhënie kredish

Të gjitha përmbajtjet lidhur me dhënie kredish janë publikuar në mediat sociale dhe janë vlerësuar si mashtrime. Faqe të dyshimta në Facebook kanë publikuar kampanja të rreme për dhënie kredish, si dhe vlerësime të klientëve të një institucioni mikrofinanciar, duke i paraqitur rrejshëm si të sajat.


3

Llojet e fushave

Bazuar në monitorimin dhe përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit mars del se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës. Politika, ashtu si në muajin paraprak, vazhdon të jetë fusha kryesore ku më së shumti u keqinformua.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Publikimi i keqinformative në një shumëllojshmëri të temave nga zhvillimet e ndryshme politike, ndërlidhur me asociacionin e komunave serbe, intervenimin e NATO-s 1999, trazirat e marsit 2004, dialogun e tjera, ka bërë që kjo fushë të mbizotërojë edhe gjatë muajit mars. Kjo ka ndikuar që, politika të ketë përqindje të njëjtë të keqinformative të gjetura dhe trajtuara, krahasuar me muajin paraprak (shkurt). Fusha e politikës pasohet nga ajo e sociale, ashtu si në muajin shkurt, por që, në mars përmbajtjet keqinformuese lidhur me këtë fushë kanë shënuar rritje prej 6% (nga 20% në muajin shkurt, në 26% në muajin mars). Këto dy fusha përbëjnë më shumë se gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara në këtë muaj.

Këto dy fusha pasohen nga fusha e sigurisë, e cila ka shënuar rritje të lehtë krahasuar më muajin paraprak (nga 18% në muajin shkurt 2024, në 21% në muajin mars 2024). Fusha e sigurisë pasohet nga ajo e kronikës së zezë, e cila ka pësuar një rënie të lehtë (nga 17% në muajin shkurt, në 15% në muajin mars).

Pothuajse të gjitha përmbajtjet nga fusha e politikës janë publikuar në gjuhën shqipe në media (15%) dhe media sociale (11%). Dezinformatat (10%), lajmi i rremë (6%) dhe artikujt clickbait (4%) janë kategoritë keqinformuese me të cilat janë vlerësuar keqinformatat për një mori temash nga fusha e politikës.

Keqinformatat nga fusha sociale janë publikuar në media sociale (13%), portale të dyshimta (5%) dhe media reale (3%). Në këtë fushë dominojnë përmbajtjet mashtruese lidhur me produkte shëruese dhe dhënie kredish.

Sa i përket keqinformatave të publikuara edhe në fushën e sigurisë pjesë e konsiderueshme janë vlerësuar si lajm i rremë (6%), dezinformatë (5%) dhe clickbait (3%). Këto janë publikuar në media sociale (13%) dhe media reale (5%) lidhur me armatosjen e FSK-së, për zhvillimet në kufirin Kosovë-Serbi dhe në Veri.

Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve te kronika e zezë janë vlerësuar si lajm i rremë (6%) dhe clickbait (5%), për raste tragjike si pretendime të rreme për vdekjen e djalit të artistit Ardit Gjebrea si dhe vdekjen mbretit Charles III, etj. Të gjitha këto përmbajtje janë publikuar në media sociale (10%) dhe media reale (5%).



89% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës, sociale, sigurisë dhe kronikës së zezë.

Llojet e publikuesve


4

Për dallim nga muaji i kaluar (shkurt) ku kishin dominuar përmbajtjet keqinformuese të publikuara në media reale, gjatë këtij muaji (mars) mbizotërojnë keqinformatat e publikuara nga faqe dhe llogari në mediat sociale. Në bazë të gjetjeve dhe trajtimeve të përmbajtjeve keqinformuese shihet një rritje prej 20% të keqinformatave të publikuara në media sociale krahasuar me muajin shkurt (nga 41% në shkurt 2024, në 61% në muajin mars 2024), duke bërë kështu që të radhitet e para. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se të gjitha keqinformatat e vlerësuara si lajm i rrem dhe mashtrim, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve të paverifikuara dhe dezinformatave janë publikuar në media sociale.

Ndërsa përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe të trajtuara e që janë publikuar në media reale (portale informative) kanë pësuar një rënie prej 23% krahasuar me muajin paraprak (nga 56% në shkurt 2024, në 33% në muajin mars 2024). Në keqinformatat e publikuara në media dominojnë artikujt clickbait dhe dezinformatat. Ndërsa, vetëm 6% janë publikuar nga portale të dyshimta.

Në krahasim me muajin shkurt 2024, publikimet keqinformuese të gjetura dhe të trajtuara në muajin mars, të publikuara në mediat sociale kanë shënuar një rritje, ato në mediat reale kanë pësuar rënie, ndërsa edhe në portale të dyshimta vërehet përqindje pothuajse e njëjtë.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




94% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale (61%) dhe në mediat reale (33%).

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformatat në gjuhën shqipe të publikuara në media, portale të dyshimta dhe faqe e llogari në mediat sociale, si rezultat i së cilës gjatë muajit shkurt 2024, publikimet në këtë gjuhë mbizotërojnë në trajtim me 94%.

Ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale, si dhe ato media sociale “telegram”, lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës dhe trajtohen pikërisht ato përmbajtje. Në kuadër të muajit shkurt 2024, janë publikuar disa përmbajtje keqinformuese ndërlidhur me incidente në vendbanimet serbe dhe zhvillime në veri, duke përbërë kështu 10% të gjetjeve dhe trajtimeve të realizuara.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Më shumë se gjysma e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe janë publikuar në media sociale (58%), ndërsa pjesa tjetër në media reale (29%) dhe portale të dyshimta (6%). Të gjitha lajmet e rreme dhe mashtrimet, si dhe një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave dhe përmbajtjeve të paverifikuara janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale. Ndërsa në media janë publikuar një pjesë e konsiderueshme e artikujve clickbait dhe disa dezinformata dhe përmbajtje të paverifikuara. Si në mediat sociale, ashtu edhe në mediat reale përmbajtjet keqinformuese u publikuan nga fusha politike, sociale dhe e sigurisë.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë publikuar në media (5%) dhe media sociale (2%). Përmbajtje e publikuara në media ishin nga fusha e politikës, ndërsa në mediat sociale nga fusha e sigurisë. Në media u publikuan dezinformata nga zëdhënësja e ministrisë së punëve të jashtme të Rusisë, Maria Zaharova ndërlidhur me intervenimin e NATO-së më 1999 dhe trazirat e marsit më 2004, dhe pretendime të pabazuara për të ashtuquajturën “Shtëpi e verdhë”, si dhe teori konspirative nga Zaharova duke përmendur Kosovën ndërlidhur me terrorizmin pas sulmit të armatosur më 22 mars në një sallë koncertesh afër Moskës. Ndërsa, në media sociale u publikua teori konspirative ku aksioni kundër barnave të kontrabanduara në veri interpretohet pa fakte si “veprim antiserb”.

Llojet e mediave sociale


Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Sa i përket publikimeve keqinformuese në media sociale, gjatë marsit, 81% e përmbajtjeve janë publikuar në Facebook 81%, në TikTok 11% dhe në Youtube 8%.

Edhe gjatë muajit mars, ashtu si në muajin paraprak, kanë vazhduar të mbizotërojnë keqinformatat e publikuara në Facebook duke shënuar përqindje të njëjtë. Edhe përmbajtjet keqinformuese në TikTok janë publikuar në pothuajse përqindje të njëjtë.

Krahas këtyre dy platformave, gjatë mars janë publikuar edhe dy përmbajtje keqinformuese në gjuhën shqipe në platformën Youtube, e që në tërësi përbënë 8% të përmbajtjeve të publikuara në mediat sociale.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara në mediat sociale për muajin mars 2024 më së shumti u publikuan në faqe (49%), llogari (22%) në Facebook, pasuar nga llogari në TikTok (11%). Krahas kësaj, 5% e përmbajtjeve u publikuan nga faqe të mediave në Facebook dhe 3% nga grupe në Facebook. Gjatë muajit mars, 8% e përmbajtjeve keqinformuese u publikuan nga kanale të ndryshme në platformën Youtube.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Mashtrim (16%), përmbajtje e paverifikuar (14%), dezinformatë (14%) dhe lajmi i rremë (14%) janë kategoritë me të cilat më së shumti janë vlerësuar keqinformatat e publikuara në Facebook. Sa i përket fushatave për të cilat më së shumti u keqinformua në Facebook dominojnë socialja (22%), politika (19%) dhe siguria (11%). Në keqinformatat e publikuara në Facebook ka pasur një shumëllojshmëri temash të ndryshme nga fushat e lartcekura, përfshi këtu mashtrime me produkte shëndetësore, përmbajtje të paverifikura të imazheve të gjeneruara me inteligjencë artificiale dhe fotografi të minatorëve të Trepçës, si dhe dezinformata ndërlidhur me zhvillimet politike, veriun etj.

03. Youtube

Përmbajtjet keqinformuese të publikuara në Youtube janë vlerësuar si lajm i rremë dhe janë publikuar nga fusha e kronikës së zezë. U publikuan dy lajme të rreme me pretendimin për vdekjen e djalit të artistit, Ardit Gjebrea, si dhe një lajm për vetëvrasjen e moderatores braziliene në Shqipëri, Andresa Ambrosio.


02. TikTok

Të gjitha përmbajtjet e publikuara në Tiktok janë vlerësuar si lajm i rremë (11%). Këto lajme të rreme të publikuara në Tiktok ishin nga fusha e sigurisë, konkretisht lidhur me pretendime të rreme për gjuajtje me armë dhe konflikt ndërmjet Njësisë Speciale të Kosovës dhe asaj të Serbisë, për ndërtimin e katër bazave ushtarake në kufi më Serbinë, si dhe për armatosjen e FSK-së me artileri të rëndë ushtarake.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.


RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



Bazuar në përmbajtjet keqinformuese të trajtuara për muajin mars 2024, në mesin e të cilave vetëm në gjashtë prej tyre janë përfolur institucionet, Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK), është institucioni më i përfolur. Ky institucion i sigurisë është përfolur nga faqe në mediat sociale ndërlidhur me pretendime për armatosjen e këtij institucioni me artilleri të rëndë ushtarake. Lidhur me FSK-në u publikua një vegëz e dyshimtë me qëllim dhurimin e fondeve për fondacionin e sigurisë së FSK-së.

Të gjitha institucionet tjera janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në media, portale të dyshimta dhe media sociale. Trepça u përdor në një imazh të publikuar me pretendimin se pamjet shfaqin minatorët duke ngrënë syfyr nën 800 metra, edhe pse fotografia ishte nga një minierë në Turqi. KFOR-i u përfol me pretendimin e rremë se ky institucion i sigurisë ka marr përsipër transportin e dinarit në Kosovë. Ndërsa Zyra për Kosovën dhe subjekti politik, Lista Serbe u përfolën në artikullin lidhur me aksionin kundër barnave të kontrabanduara në Veri, i cili u interpretua pa fakte nga këto dy institucione si “veprim antiserb”.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur në kontekst me personalitete tjera, në tre përmbajtje keqinformuese ku janë përfolur personalitetet. Kurti u përfol së bashku me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq në pretendime se janë takuar për dialogun Kosovë-Serbi, si dhe në deklaratën e vjetër të ripublikuar si aktuale të Vuçiqit lidhur me mos pranimin e asociacionit. Në media është ripublikuar fotografia e montuar e Kurtit me ish-presidentin serb, Vojislav Koshtunica.

Figura e dytë më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në muajin mars është Maria Zaharova, zëdhënësjja e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë. Zaharova u përfol në media lidhur me deklaratat e saja publike duke dezinformuar për intervenimin e NATO-së më 1999 dhe trazirat e Marsit 2004, si dhe përmendjen e Kosovës lidhur me terrorizmin pas rastit të sulmit të armatosur në një sallë koncertesh në afërsi të Moskës më 22 mars.

Të gjithë personalitet tjera, janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara gjatë muajit mars.



Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE

Deklaratë të paqëndrueshme

Shëndetësi

Pagat e mjekëve

Arben Vitia

Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit mars, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar një deklaratë.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia në një intervistë, të publikuar me 25 shkurt për Agjencinë e lajmeve, ka deklaruar se mjekët në Kosovë kanë një nga rrogat më të larta në regjionin e Ballkanit Perëndimor. Pas verifikimit të fakteve nga hibrid.info, është vërtetuar se në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, vetëm Serbia ka paga më të ulëta për mjekët, në krahasim me Kosovën, gjë e cila sipas vlerësimit, e bën deklarinimin e ministrit Vitia, si të pasaktë.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 mars 2024, në të cilën janë trajtuar 62 përmbajtje keqinformuese.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit mars 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Bazuar në monitorimit dhe trajtimit të 62 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit mars 2024, rezulton që artikujt clickbait me 21% dhe lajmi i rremë me 21% kanë dominuar për sa i përket kategorive keqinformuese. Për shkak që gjatë këtij muaji, keqinformata nuk janë fokusuar në një temë që ka marrë përqendrimin kryesor dhe se disa përmbajtje keqinformuese nga fusha kryesore janë vlerësuar si clickbait dhe lajm i rremë, ka bërë që këto kategori të radhiten me përqindjen më të lartë. Këto dy kategori pasohen nga dezinformata me 20%, mashtrime, përmbajtje të paverifikuara etj.

Keqinformata të publikuara nga publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe media sociale) për zhvillime në fushën e sigurisë në veriun e Kosovës, ka bërë që kjo temë me 8% të dominojë gjatë muajit mars. Shumëllojshmëria e temave ka bërë që, edhe pse kjo temë mbizotëron, përqindja e keqinformatave lidhur me të është e ulët. Krahasuar me muajin paraprak (shkurt), tema e veriut me 5% radhitej si e gjashta në mesin e temave për të cilat u keqinformua më së shumti. Gjatë këtij muaji u publikuan disa përmbajtje mashtruese lidhur me pretendime për produkte që shërojnë sëmundje të ndryshme. Në kuadër të përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara gjatë këtij muaji, janë publikuar lajme të vjetra lidhur me kushtet klimatike më pretendimin t'i paraqesin si aktuale. Po ashtu, janë publikuar edhe përmbajtje mashtruese me pretendimin për dhënie kredish apo shprehje të kënaqësisë së konsumatorëve për kreditë. Përmbajtjet e koduara si raste tragjike (vdekje e vrasje), ku përveç artikujve clickbait për të cilat nuk bëhet e ditur në titull vendndodhja e ngjarjes, janë publikuar edhe lajme të rreme me pretendime për vdekjen e djalit të artistit Ardit Gjebrea, etj.

Sa i përket fushave, politika me 27% vazhdon të jetë fusha kryesore ku më së shumti u keqinformua, pasuar nga socialja me 26% dhe siguria me 21%. Publikimi i keqinformatave në një shumëllojshmëri të temave nga zhvillimet e ndryshme politike, ndërlidhur me asociacionin e komunave serbe, intervenimin e NATO-s 1999, trazirat e marsit 2004, dialogun e tjera, ka bërë që kjo fushë të mbizotërojë edhe gjatë muajit mars. Pothuajse të gjitha përmbajtjet nga fusha e politikës janë publikuar në gjuhën shqipe në media (15%) dhe media sociale (11%).

Dezinformatat (10%), lajmi i rremë (6%) dhe artikujt clickbait (4%) janë kategoritë keqinformuese me të cilat janë vlerësuar keqinformatat për një mori temash nga fusha e politikës. Fusha e politikës pasohet nga ajo e sociale, ku keqinformatat nga kjo fushë janë publikuar në media sociale (13%), portale të dyshimta (5%) dhe media reale (3%), e që dominojnë përmbajtjet mashtruese lidhur me produkte shëruese dhe dhënie kredish. Këto dy fusha pasohen nga fusha e sigurisë, e që një pjesë e konsiderueshme janë vlerësuar si lajm i rremë (6%), dezinformatë (5%) dhe clickbait (3%) si dhe janë publikuar në media sociale (13%) dhe media reale (5%), që kishin të bënin lidhur me armatosjen e FSK-së, për zhvillimet në kufirin Kosovë-Serbi dhe veri.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur në kontekst me personalitete tjera, si me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq në pretendime se janë takuar për dialogun Kosovë-Serbi, si dhe në deklaratën e vjetër të ri-publikuar si aktuale të Vuçiqit lidhur me mos pranimin e asociacionit. Në media është ri-publikuar fotografia e montuar e Kurtit me ish-presidentin serb, Vojislav Koshtunica. Figura e dytë më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në muajin mars është Maria Zaharova, zëdhënësja e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, lidhur me deklaratat e saja publike duke dezinformuar për intervenimin e NATO-së më 1999 dhe trazirat e Marsit më 2004.

Në kuadër të kontrollit të deklaratave dhe premtimeve është trajtuar deklarata e Ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia në një intervistë, të publikuar me 25 shkurt ku pati deklaruar se mjekët në Kosovë kanë një nga rrogat më të larta në regjionin e Ballkanit Perëndimor. Pas verifikimit të fakteve nga hybrid.info, është vërtetuar se në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, vetëm Serbia ka paga më të ulëta për mjekët, në krahasim me Kosovën, gjë e cila sipas vlerësimit, e bën deklarinimin e ministrit Vitia, si të pasaktë.

HIBRIDO.INFO